

2007

Arqile Kosta

DOKTRINA E TE DREJTAVE TE NJERIUT

Doktrina e të drejtave humane synon të identifikojë kushtet paraprake themelore që çdo qenie humane të gëzojë një minimum jetik të domosdoshëm. Në këtë sens ajo ka për qëllim të identifikojë si parakushtet pozitive, edhe ato negative për një minimum jetik më të mirë, si të drejtën për të mos iu nënshtruar asnjë torture apo qëndrimi çnjerzor e diskriminues dhe të drejtën për të pasur kujdes minimum shëndetësor. Ky inspirim është përvijuar dukshëm në deklarata e konventa të ndryshme, të shpallura gjatë 50-60 vjetëve të fundit, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) dhe të përsëritura me forcë më të madhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (1954), dhe në Konventën për të Drejtat Civile dhe Ekonomike (1966).



Hyrje: Drejtat e Njeriut në kohët e sotme

Të drejtat e njeriut përkufizohen si “garanci bazë morale, që duhet t’i gëzojnë të gjithë njerzit, në të gjitha vendet e kulturat, vetëm dhe pikërisht sepse janë qenie humane”. Duke i quajtur këto garanci “të drejta” ato i bashkëngjiten çdo individ të veçantë me qëllim që të mund t’u referohet dhe t’i invokojë. Ato janë të një prioriteti të lartë dhe se bindja e respektimi i tyre janë të detyrueshme, të pacënueshme dhe nuk mund të përzgjidhen sipas dëshirës.

Të drejtat e njeriut zakonisht konsiderohen si të drejta universale në sensin që çdo njeri i ka ato dhe duhet t’i gëzojë pa dallime dhe të pavarura në sensin që ato egzistojnë njëlloj për të gjithë dhe janë të disponueshme si standarde të justifikimit dhe të kritikës, sidoqë mund të jenë ose jo të njohura e të implementuara nga sistemet ligjore apo zyrtarët e vendeve të veçanta.

Doktrina e të drejtave humane synon të identifikojë kushtet paraprake themelore që çdo qenie humane të gëzojë një minimum jetik të domosdoshëm. Në këtë sens ajo ka për qëllim të identifikojë si parakushtet pozitive, edhe ato negative për një minimum jetik më të mirë, si të drejtën për të mos iu nënshtruar asnjë torture apo qëndrimi çnjerzor e diskriminues dhe të drejtën për të pasur kujdes minimum shëndetësor. Ky inspirim është përvijuar dukshëm në deklarata e konventa të ndryshme, të shpallura gjatë 50-60 vjetëve të fundit, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948) dhe të përsëritura me forcë më të madhe në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (1954)¹ dhe në Konventën për të Drejtat Civile dhe Ekonomike (1966).

Të tri sëbashku këto dokumenta, duke patur të njëjtën qëndër të rëndësës, përbëjnë buqetën instrumentale të doktrinës të së Drejtës Humane, që të vlerësohet e aftë mjaftueshme për të paraprirë një rend gjeopolitik bashkëkohor mbarëeuropian. Megjithatë, ajo nuk ka për qëllim të shndërohet në një doctrine morale të plotë e të gjithanëshme. Sipas këtij këndvështrimi apeli që ajo bën për të respektuar e mbrojtur të drejtat e njeriut nuk mund të jetë njëkohësisht edhe një shpjegim i gjithanshëm i konceptit të moralitetit “per se”. Doktrina nuk mundet, për shëmbull, të garantojë kriteret e dhëna për të dhënë përgjigje për çështje të tilla si “a përbën imoralitet të brendshëm thënia e gënjeshtrove, ose në çfarë përmasë dhe shtrirje duhet të jenë moralisht të obliguar dhe të mbajnë përgjegjësi morale shokët, miqtë dhe kolegët për të dashur dhe respektuar njeri tjetrin?

Ajo, që e shndëron doktrinën për të drejtat e njeriut në një qëllim parësor, është vlerësimi dhe identifikimi i bazave më të thella morale të formulimit, përmbajtjes dhe qëllimit të normave publike (ligjeve) më themelore të shoqërisë moderne dhe demokratike. Gjithashtu, vënia e theksit mbi një bazë të tillë doktrimore shërben edhe si një vijë ndarëse midis konceptit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe konceptit demokratik për to. Doktrina e të drejtave humane ka për qëllim të garantojë dhe të pajisë individët me kushtet e domosdoshme për të pasur dhe për të synuar një minimum jetik të mirëqënies personale.

Autoritetet publike, si ato kombëtare edhe ato ndërkombëtare, janë identifikuar tashmë si pozicioni më tipik i pushtetit dhe vendi më i mirë për t’i vendosur këto kushte të domosdoshme në baza të sigurt, e në këtë mënyrë doktrina e të drejtave humane, për mjaft njerëz është shndëruar në bartësin e parë të standardeve, të cilave u referohen për të përcaktuar cilat do të ishin garancitë bazë morale e ligjore, të cilat ka të drejtë t’i presë gjithkush prej nesh, jo vetë nga njeri tjetri, por gjithashtu edhe nga institucionet vendore e ndërkombëtare, që janë në gjendje të influencojnë direkt apo indirekt mbi interesat tona më të qënësishme.



DOKTRINA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Doktrina aspiron të garantojë rendin social, përkatësisht atë post-ideologjik dhe gjeopolitik të kohës, me një kornizë të përbashkët ligjore dhe morale në bazë të të cilës do të përcaktohen kushtet më të domosdoshme ekonomike, politike dhe sociale për të gjithë individët, me qëllim që ata të gëzojnë një minimum jetik të pranueshëm. Megjithë efikasitetin praktikë që ka promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, është e rëndësishme të theksohet se ajo duhet mbështetur nga shtetet e veçanta, përmes implementimit dhe njohjes ligjore të kësaj doktrine, por nga ana tjetër vlefshmëria, besueshmëria dhe fuqia ligjore e të drejtave të njeriut në mënyrë karakteristike nuk varet në mënyrë të kushtëzuar nga këto implementime.

3

Justifikimi moral i të drejtave të njeriut është një qëllim, një ide dhe kujdes që duhet t'iu paraprijë si autoriteti më i lartë, vlerësimeve dhe konsideratave për një sovranitet kombëtar të caktuar. Nënvizimi i aspiratës dhe frymës së doktrinës ka të bëjë me nevojën për të garantuar një set të kriterëve legjitime, për të cilat duhet të aspirojnë e të japin mbështetjen e tyre të gjitha shtetet. Thirrjet për sovranitet kombëtar nuk mund të shndërohen në mjete që përligjin shtetet t'iu shmangen angazhimeve të tyre themelore që bazohen tek të drejtat e njeriut. Ajo pozicionohet qartësisht dhe në mënyrë ideale për të garantuar individin human me një mjet të fuqishëm dhe të pushtetshëm për të kontrolluar e shqyrtuar në mënyrë të moralëshme legjitimitetin e formave politike edhe ekonomike të kohës, të autoriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare që qeverisin. Kjo nuk është aspak një përmasë e vogël e moralit të kohës dhe e rëndësisë politike të kësaj doktrine. Për mjaft nga mbështetësit e saj më të zëshëm, qëllimi i kësaj doktrine është të paraqesë dhe garantojë baza të përligjura të një morali fundamental për rregullimin e rendit dhe marrëdhënieve gjeopolitike të kohës.

Ideja se kemi qënë dhe do të vazhdojmë të mbetemi të bashkuar edhe internacionalisht të lidhur përmes një kodi moralo-ligjor, na shtyn të bëjmë përpjekje që këtë kod ta aplikojmë për të mbrojtur çdo njeri dhe çdo gjë tjetër në nevojë dhe pa mbrojtje. Mizoria dhe egërsia mbeten të tilla edhe kur ushtrohen ndaj njerzve e kombeve edhe kur ushtrohen ndaj kafshëve, bimësisë apo planetit. Të gjithë duhen mbrojtur, edhe njerzit, edhe mjedisi, edhe pasuria jonë e përbashkët, sepse kështu do të ndihmojmë në formimin e një gjeneratë të re njerzish më të mirë, pikërisht sepse kjo gjeneratë do të shohë kujdesin që tregojnë prindërit e tyre.

Një nga asetet më të rëndësishëm të të Drejtave themelore dhe një gurët e çmuar të listës së specieve, të cilit i duhet dhënë dhe në fakt i jepet mbrojtje e fortë ndërkombëtare është "informacioni" ose e drejta për informacion të lirë e të paanshëm. Ky aset i brishtë ndodhet veçanërisht nën kërcënim prej atyre, që mund të ndikojnë drejtpërdrejt mbi njoftimet dhe pamjaftueshmëritë e tij. Për shkak të keqinformimit të përgjithshëm, presionit mbi institucionet e pavarura gjyqësore dhe indiferencës publike, viktimat rrezikojnë të mbeten përgjithmonë të viktimizura:

"Manipuluesit profesionistë të mendjeve duhen identifikuar, demaskuar dhe veprimtaria e tyre duhet shpallur e paligjëshme. Liria e shprehjes dhe e fjalës nuk duhet ngatëruar e përzierë me lirinë për të manipuluar informacionin dhe opinionet, për arritjen e një qëllim apo për të mundësuar që të funksionojë një veprimtari, qoftë e mirë apo e keqe".²

"... veç kësaj, zyrtarët e lartë të MRP çenojnë e nëpërkëmbin parimin e prezumimit të pafajsisë, për të personat e ndaluar dhe arrestuar, që duhet të përballen me procesin gjyqësor, duke e bërë publike fajësinë e tyre, para se gjykata të ketë vendosur me një vendim të formës së prerë për çështjen".³



Natyrja e të Drejtave të Njeriut

Një nga çështjet fillestare të çdo dije filozofike është ajo që ka të bëjë me domethënien e të drejtave të njeriut. Problemi nuk është i parëndësishëm. Qëniet humane, sikurse thotë Sartri, janë “Froni i të menduarit”. Të menduarit në vetvete do të thotë të pyesësh “Pse?”. Veçanërisht në sferën ndërkombëtare, ku përfshihen dhe hyjnë në marrëdhënie një diversitet kulturash, ku shpjegimet pozitiviste janë të lëkundëshme dhe ku mekanizmat e implementimit janë delikate e të brishta, qartësia dhe saktësia janë kurciale. Natyrisht, disa teori e shkolla filozofike i qëndrojnë pikpamjes se e tërë detyra e filozofisë është të përqëndrohet tek kuptimi dhe domethënia e gjërave. Nga mënyra si dikush e kupton brendinë, domethënien dhe natyrën e të drejtave të njeriut, do të influencohet pastaj në gjykimet dhe vendimet që do të marrë për çështje si ajo e universalitetit të të drejtave të njeriut, të përcaktimit të prioriteteve, të mundësisë për tu nënështuar ndaj interesave të tjera, të përcaktimit të nevojës për presione apo mbështetje ndërkombëtare, kërkimit të programeve për tu implementuar dhe se ku do të duhet të luftohet përmes lëvizjeve socialpolitike dhe socialekonomike.

Çfarë do të kuptohet me “të Drejta të Njeriut”? Për të folur rreth të drejtave të njeriut kërkohet para së gjithash një konceptim apo një ide mbi të drejtën, që zotëron dikush vetëm sepse ka cilësinë të jetë qenie humane. Kjo nuk nënkupton të drejtat e njeriut në sensin e vetkuptueshmërisë, pra se ata që i kanë këto të drejta janë qenie njerzore, por përkundrazi, se këto të drejta njerzorit i kanë ato pikërisht se janë qenie humane, pavarësisht nga rrethanat e ndryshme sociale dhe nga shkalla e meritës.

Disa i identifikojnë të drejtat e njeriut si ato që janë “të rëndësishme”, “morale” dhe “universale”. Megjithëse është mjaft komode t’i zbulosh të drejtat e njeriut me të tilla karakteristika e superlativa, në vetvetetribute të tilla kanë mjaft paqartësi dhe dykuptimësi. Psh, kur dikush thotë se një e drejtë është e rëndësishme mjaft që të jetë e drejtë humane, mund ta ketë fjalën për një ose disa nga cilësitë e saj: (1) si vlerë e brendësuar; (2) si vlerë instrumentale; (3) si vlerë në një nga skemat e së drejtës; (4) si rëndësi që nuk peshon më shumë nga vlerësimet e tjera, ose (5) rëndësi si një suport strukturor për sistemin e jetesës normale. Nga ana tjetër cilësimet “Universale” and “morale” janë ndoshta fjalët më të komplikuar. Çfarë i bën disa të drejta të konsiderohen universale, morale apo të rëndësishme? Kush vendos për këtë gjë? 4

Teoricienët intuitivistë të filozofisë së moralit pohojnë se përkufizimet mbi të drejtat e njeriut janë të pakuptimta sepse ato përfshijnë gjykimin moral për gjëra që janë të vetkuptueshme dhe që nuk kanë nevojë për shpjegime të tjera. Të tjerë moralistë fokusohen në pasojat e të drejtave të njeriut dhe qëllimet e tyre. Shkolla preskriptiviste (normative) e filozofisë së moralit deklaroi se nuk duhet përqëndruar rreth asaj që kërkohet të arrihet prej një çështje morale (të drejtave të njeriut) si një mënyrë të shprehuri, por rreth asaj që është arritur në realitet.

Natyrisht që nuk është dhe aq e lehtë të arrihet një përcaktim i qartë i procesit kur bëhet fjalë për të shqyrtuar termin “të drejtat e njeriut”. Vetë termi “e drejtë” është padyshim një “term-kameleon”, që merr trajta nga më të ndryshmet në vartësi të marrëdhënieve ligjore ku përfshihet: disa herë termi “e drejtë” përdoret në një sens mjaft strikt për të treguar disa mbajtës të saj në raport me disa të tjerë që kanë detyra të lidhura me to, psh kur themi se dikush k një të drejtë, nënkuptojmë shpesh edhe dikë tjetër që ka për detyrë ta garantojë atë të drejtë; disa herë të tjera termi përdoret për të treguar një imunitet kundrejt një ndryshimi të statusit të tij ligjor; herë të tjera ky term tregon një privilegj për të bërë ose jo diçka dhe herë herë ai i referohet një fuqie apo pushteti për të kjuar një marrëdhënie ligjore. Megjithëse, të gjitha këto përdorime kanë të bëjnë me termin “e drejtë”, ato në fakt invokojnë mbrojtje të natyrave të ndryshme.



Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se në një kohë kur në kuadrin e ligjit ndërkombëtar kemi të përcaktuar qartë një sistem konvencional për të drejtat e njeriut, kuptimi dhe shpjegimi filozofik i natyrës të të drejtës nuk është thjesht në detyrë akademike. Të kuptuarit e natyrës të “të drejtës” mund të ndihmojë të sqarohet shkalla e nevojëshme dhe ajo e disponueshme e mbrojtjes së saj, natyra e heqjes ose e përjashtimeve që mund të bëhen, prioritetet që do t’u jepen të drejtave të ndryshme, çështjet e marrëdhënive hierarkike në një seri të drejtash, çështja nëse të drejtat “trumps” ndeshen e konkurojnë me të drejtat e deklaruara të bazuara mbi një zanafillë kulturore dhe probleme të tjera të ngjashme.

Përgjigjet për çështje të tilla mund të përpunohen e të gjendet me kalimin e kohës përmes rregullimeve ligjore, interpretimeve, vendimeve dhe kompromiseve pragmatiste. Por, për të influencuar në arritjen e këtyre përgjigjeve, padyhim është e nevojëshme që ato të udhëhiqen nga një shpjegim e argumentim filozofik i të drejtave në fjalë. Pika e nisjes për kuptimin e themeleve morale të ligjit për të drejtat e njeriut është shqyrtimi i burimeve teorike dhe i praktikave të deklarimit të të drejtave të njeriut në kontekstin evropian.

Origjina historike, teoria dhe praktikat e të Drejtave të Njeriut

Doktrina e të drejtave humane mbështetet mbi pohimin filozofik të veçantë dhe fundamental: se egziston një rend, apo një rregull moral i identifikueshëm racionalisht (në mënyrë të arsyeshme), i cili në mënyrë të ligjeshme paraprin rastin social, kushtet historike dhe aplikohet njëllë për të gjitha qëniet humane kudo dhe në çdo kohë. Sipas kësaj pikpamje, besimet dhe konceptet morale kanë aftësinë për tu provuar dhe konsideruar në mënyrë objektive si të vërteta fundamentale dhe universale. Doktrina moderne e të drejtave të njeriut në fakt është një nga shumë këndvështrimet etike universaliste.

Origjina dhe zhvillimi i kësaj teorie të të drejtave të njeriut është e lidhur pazgjithshmërisht me zhvillimin e etikës universaliste në përgjithësi. Historia e përpunimit filozofik të doktrinës për të drejtat humane është nënvizuar dhe ndërtuar nga segmente specifike të një numuri teorish të doktrinave morale që, megjithse në vetvete nuk janë të plota dhe shprehje të mjaftueshme të të drejtave humane, padyshim kanë krijuar kushtet paraprake të domosdoshme për lindjen e doktrinës moderne të të drejtave humane. Këto përfshijnë pikpamjet për moralin dhe drejtësinë si të prejardhura nga disa sfera parasociale, identifikimi i të cilave na pajis me bazat e nevojëshme për të dalluar midis “të vërtetës” dhe parimeve dhe besimeve të moralit të thjeshtë “konvencional”. Parakushtet esenciale për mbrojtjen e të drejtave humane përfshijnë gjithashtu konceptin mbi individin si bartës të disa të drejtave “natyrore” dhe një pikpamje të veçantë rreth vlerave të qënësishme, të pandashme dhe të barabarta për çdo qenie apo individ huamn të arsyeshëm.

Të drejtat e njeriut bazohen mbi etikën universaliste dhe besimin se egziston një e vërtetë morale universale në komunitetin që përfshin të gjithas qëniet njerzore. Universalizmi Moral parashtron egzistencën e të vërtetave morale trans-kulturore dhe trans-historike të identifikueshme me anën e arsyes. Origjinat e universalizmit etik në Europë i referohen më së pari shkrimeve të Aristotelit dhe të shkollës filozofike të Stoikëve. Tek “Etika e Nikomachean”, Aristoteli në mënyrë mjaft të qartë parashtron dhe shpjegon argumenta në mbështetje të egzistencës të një rendi moral natyror. Ky rend moral natyror, sipas tij, duhet të garantojë dhe të krijojë kushtet paraprake për të gjitha sistemet me të vërtetë të arsyeshme të drejtësisë. Në emër dhe në bazë të këtij rendi moral natyror parashikohen një set i pandryshueshëm kriteresh gjithëpërfshirëse, të plota dhe potencialisht universale për vlerësimin e legjitimitetit të sistemit ligjor aktual të formuluar nga njerzit.



Duke bërë dallim midis “drejtësisë natyrore” dhe “drejtësisë ligjore”, Aristoteli shkruante se “me natyrore do të kuptohet ajo që ka kurdoherë të njëjtën vlerë e fuqi ligjore dhe që nuk varet nga pranimi apo mospranimi i njerzve”. (Aristotel - *Nicomachean Ethics*, 189). Kriteri për përcaktimin e një sistemi me të vërtetë racional e të arsyeshëm të drejtësisë, paraprin marrëveshjet dhe traditat socialhistorike. “Drejtësia natyrore” u paraprin edhe konfigurimeve specifike socialpolitike. Mënyra për të përcaktuar formën dhe përmbajtjen e së drejtës natyrore është çlirimi i arsyes nga efektet deformuese e shpërfytyruese të paragjyqimeve dhe dëshirave vetiake.

6

Kjo ide bazë është shprehur në të njëjtën mënyrë edhe nga stoikët romakë, si Ciceroni dhe Seneka, të cilët argumentonin se moraliteti e ka origjinën tek vullneti racional i zotit dhe nga egzistenca e një shteti kozmik, universal, tek i cili njeriu mund të dallojë ligjin natyror moral, prej të cilit rrjedh autoriteti i të gjitha kodeve ligjore lokale. Stoikët argumentonin se ky kod etik universal imponon tek të gjithë njerzit detyrën për t’iu bindur e nënështuar këtij vullneti universal. Stoikët në këtë mënyrë i ëndronin besnikë pikpamjes se egzistenca e komunitetit moral universal influencohet tejprtej nga marrëdhëniet tona me këtë vullnet suprem. Ndërsa disa kanë vrejtur aludime dhe një lloj ngushtësie tek koncepti mbi të drejtën dhe të moralëshmen në shkrimet e Aristotelit, të Stoikëve dhe të teologëve, knncepti mbi të drejtën që i përafrohet idesë moderne të të drejtave të njeriut u vrejt më qartë gjatë shekujve 17^{te} dhe 18^{te} në Europë tek e ashtuquajtura doktrina e “ligjit natyror”.

Në themel të doktrinës të të drejtave të njeriut qëndron besimi mbi egzistencën e një kodi moral natyror, që bazohet në identifikimin dhe njëtesimin e disa cilësive personale të çdo qenie humane, të cilat janë sa themelore, aq dhe objektivist të verifikueshme. Të gëzuarit e këtyre të mirave duhen garantuar nëpërmjet posedimit të disa të drejtave e lirive natyrore, që janë plotësisht e thellësisht të barabarta, e që respektimi, dhënia dhe garantimi i tyre të jetë i kontrolluar dhe i verifikuar me ligj.

Ligji natyror supozohet të jetë parakushti i çdo sistemi social e politik. Të drejtat natyrore në mënyrë të njëjtë do të paraqiten si të drejta të individit, të cilat ai i posedon pavarësisht nga shoqëria dhe politikat e kohës. Të drejtat natyrore në mënyrë të njëjtë paraqiten si rezultati fundit i mirëqënë dhe i pavarur që duhet të arrihet dhe të përftohet nëse ato miratohen nga çdo autoritet politik ose parlament i dhënë.

Përfaqësuesi më thelbësor kuintesencial i këtij pozicioni ishte mendimtari i shquar i shekullit të 17^{te}. John Locke dhe, veçanërisht argumenti që ai nënvizonte tek vepra e tij “Dy traktate të qeverisjes” (1688). Në qendër të argumentave të Lock është pohimi se individët posedojnë të drejta natyrore, pavarësisht nga njohja dhe pranimi politik që u akordohet atyre nga shteti. Këto të drejta posedohen pavarësisht, madje përpara formimit të çdo komuniteti politik. Lock argumenton dhe mbron idenë se të drejtat natyrore rrjedhin nag ligji natyror, kurse ligji natyror vetë rrjedh nga vullneti absolut mbinatyror.

Ky vullnet i përpiktë, i mbinatyreshëm përbën thelbin më të thellë dhe përfundimtar që bën të besueshëm dhe autoritativ çdo kod moral. Si pasojë, secili prej nesh është i detyruar të mbrojë dhe të respektojë një kod të tillë moral. Për ta kryer me sukses këtë detyrë të vetmbrojtjes, çdo njeri duhet të jetë i lirë nga kërcënimet që i bëhen jetës dhe lirisë së tij, nga njera anë dhe nga ana tjetër prej tij kërkohet, atë që Lock e konsideron themelore, të përdorë mjete pozitive për t’u vetmbrojtur: vetitë personale. Detyra e gjithësecilit për të vetmbrojtur të drejtat natyrore bën të detyrueshme ekzistencën dhe repektimin e domosdoshëm të të drejtave bazë natyrore të jetës, lirisë dhe pronës. Locke vijon duke argumentuar se qëllimi principlial i investurës të autoriteteve politike në një shtet sovran është pajisja, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave natyrore të njeriut.



DOKTRINA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Për Locke, mbrojtja dhe përkrahja e të drejtave natyrore të njeriut ka qënë, është dhe duhet të jetë i vetmi justifikim për krijimin e qeverive.

Të drejtat natyrore për jetën, për lirinë dhe pronën caktojnë qartë cilat janë kufijtë e autoriteti dhe të juridiksionit të Shtetit. Shteti, sipas Lock, egziston për t'u shërbyer interesave, të drejtave natyrore, të njerzve dhe jo se është monarku apo një strukturë sunduese mbi njerzit. Locke shkon aq larg në argumentat e vet saqë i konsideron individët të justifikuar moralisht kur ata rrëmbejnë armët kundër qeverisjes dhe autoriteteve politike të tyre, kur ato në mënyrë sistematike dhe të vetëdijshme shkulin apo dështojnë në detyrën e tyre për t'u garantuar qytetarëve të shtetit që të gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat e tyre natyrore.

Analiza e pararendësve historikë të teorisë së sotme për të Drejtat e Njeriut, i rezervon një vend të rëndësishëm kontributit të sjellë nga Lock në këtë fushë. S'ka dyshim që ai parashikoi dhe argumentoi se si pararendësit e autoritetit të sotëm politik, në shoqëritë e "shtetit të së drejtës" e bazojnë, e legjitimojnë dhe duhet ta ndërtojnë pushtetin e tyre mbi themelet të drejta. Megjithatë, përpunimi dhe plotësimi i bazave të përshtatëshme filozofike teorike të të drejtave të njeriut pati nevojë të thellohej akoma më shumë duke integruar më mirë arsyetimet e sistemuara shkencore të shkencës së moralit, që nga ana e vet është po aq i përputhshëm me konceptin e të drejtës, por që nuk ka nevojë të domosdoshme për të kërkuar mbështetje tek autoriteti suprem mbinatror për të justifikuar që qëniet humane duhet të gëzojnë në mënyrë të barabartë dhe të verifikojnë respektimin e disa të drejtave themelore. Një integrim dhe trajtim të tillë sistematik solli kontributi i mendimtarit gjerman të shekullit të 18^{të}, Emanuel Kant.

Mjaft nga temat qëndrore të paraqitura fillimisht nga Kanti mbeten ende të spikatura dhe të rëndësishme edhe në argumentimet moderne të të drejtave të njeriut. Më të shquarat ndërmjet tyre janë pikpamjet mbi idealin e barazisë dhe autonomisë morale të qënieve të arsyeshme humane. Kanti e ngriti teorinë kontemporane të të drejtave të njeriut në nivelin e një ideali të aplikueshme në mënyrë universale nga e gjithë bashkësia humane e qënieve të arsyeshme. Sipas tij individët e arsyeshëm duke u bazuar tek ky ideal universal përcaktojnë më pas të gjitha parimet morale të tyre për të krijuar kushtet e favorëshme ku të sigurojnë dhe të gëzojnë barazinë dhe autonominë e dëshiruar. Kanti parashikon edhe një mjetin që do të justifikojë të drejtat humane si bazë për vetvendosjen që rrjedh nga bhrendësia e autoritetit të arsyes humane.

Filozofia morale e Kantit bazohet më tepër tek apeli që bën nevoja për parimet etike formale, sesa për të synuar arritjen e konceptit të së mirës thelbësore humane. Për Kantin, përcaktimi i çdo të mire me një natyrë të tillë thelbësore, mund të burojë vetëm nga përcaktimi korrekt i karakteristikave formale të arsyes humane. Ai, për këtë shkak nuk flet për mjete apo mënyra themelore të dhëna njëherë e përgjithmonë, por për premisa bazë, sipas të cilave do të përcaktohen dhe vlerësohen rezultatet, apo objektivat e arsyetimit human.

Filozofia morale e Kantit nis me përpjekjen e tij për të identifikuar në mënyrë korrekte parimet bazë të arsyetimit (vendimmarrjes) humane, të cilat mund të aplikohen njëllor për të gjithë personat e arsyeshëm, pavarësisht nga dëshirat dhe interesat e tyre të veçanta apo të pjesëshme. Në këtë mënyrë, Kanti, i bashkëngjit nevojës për të përcaktuar dhe identifikuar parimet morale të shoqërisë, kushtin e "universalitetit". Për të, bazat e arsyetimit moral duhet të mbështeten mbi kushtin se të gjithë individët e arsyeshëm janë të kushtëzuar ta pranojnë dhe miratojnë. Kështu, sipas Kantit, të bësh mirë një gjë, nuk përcaktohet nga fakti se veprimi është bërë në përputhje me dëshirat apo interesat personale, por nga të vepruarit në përputhje me një parim, të cilin janë të detyruar dhe të kushtëzuar ta pranojnë të gjithë individët e arsyeshëm. Kanti e quan këtë parim "imperativ kategorik". Ai argumenton se kushti bazë i universalitetit që përcakton parimin moral të



rregullimit të marrëdhënieve njerzore, është shprehje e domosdoshme e autonomisë morale dhe e barazisë themelore për të gjithë individët e arsyeshëm.

Imperativi kategorik është një parim që vetimponohet tek personat e arsyeshëm moralisht autonomë dhe ligjërish të barabartë. Nga ana tjetër, sipas Kantit, imperativi kategorik, na pajis me bazën e duhur për të përcaktuar qëllimin dhe formën e atyre ligjeve, të cilat nga ana e tyre, do të institulojnë qytetarë moralisht autonomë dhe ligjërish të barabartë dhe në kushte të garantuara njëjloj për të gjithë. Për Kantin, kapaciteti për të marrë vendime dhe vepruar në mënyrë të arsyeshme, është karakteristikë dalluese e qënies humane dhe baza me të cilën mund të verifikohet dhe të shpjegohet dinjiteti human. Si një karakteristikë dalluese e qënies humane, formulimi i parimeve të ushtrimit të veprimit të arsyeshëm duhet në mënyrë të domosdoshme të kalojë me sukses testin e universalitetit, pra duhet të jetë në gjëndje të pranohet dhe të njihet si i tillë nga të gjithë faktorët e barabartë për sa i përket aftësisë për të menduar në mënyrë të arsyeshme. Që nga koha kur Kanti formuloi “imperativin kategorik”, filozofia u bë një teori abstrakte, që i reziston çdo përpjekje për ta kuptuar dhe shpjeguar thjeshtë e lehtë. Megjithëse shpesh ajo sheh përtej shpjegimeve dhe vlerësimeve mbi zhvillimin historik të të drejtave të njeriut, kontributet e saj mbi doktrinën e të drejtave të njeriut kanë qënë të thella dhe themelore.

Kanti u kujdes dhe parashikoi formulimin e parimeve morale themlore që, megjithse tej mase abstrakte e formale, bazohen mbi idealin e dyfishtë të barabartësisë dhe të autonomisë morale. Të drejtat e njeriut janë të drejta që ne i japim vetes, duke u konsideruar qënie humane autonome dhe formalisht (ligjërish) të barabarta. Për Kantin, çdo e drejtë e tillë e ka origjinën në karakteristikat dhe cilësitë formale të arsyes humane dhe jo në ndonjë vullnet e arsye mbinjerzore.

Idetë filozofike të mbrojtura nga pasuesit e J. Locke dhe E. Kant bashkëshoqëruan gjithë përpjekjet për projektimin e rilindjes europiane të shekujve 17^{te} dh 18^{te}, influencat e së cilës u përhapën në të gjithë globin në shekujt që vijuan. Ideale si të drejtat natyrore, autonomia morale, dinjiteti njerëzor dhe barabartësia siguruan themelet e forta normative për përpjekjet e mëvonëshme të rikonstruktimit dhe reformimit të sistemeve politike të së ardhmes, të përmbysjes ligjore dhe dhënies fund të regjimeve despotike e diktatoriale në përpjekje për t'i zëvendësuar me autoitete politike të afta që t'i mbronin dhe nxisnin këto ideale të reja emancipuese. Këto ideale influencuan dukshëm, ndonëse në forma revolucionare, gjithë ndryshimin dhe hopin politik që bashkëshoqëroi shekullin e 18^{te}, që përmbajnë dokumenta të tillë si “Deklarata e Pavarësisë” e SHBA dhe “Deklarata mbi të Drejtat e Qytetarit” e Asamblesë Kombëtare të Francës. Në mënyrë të ngjashme, koncepti i të drejtave të individit vazhdoi të tingëllonte edhe gjatë shekullit të 19^{te}, nën përpjekjet e lëvizjeve social-politike të Mary Wollstencraft për të drejtat e grave dhe lëvizje të tjera, që synonin të drejtën e votes për ato segmente të shoqërisë, të cilat ishin të privuara nga të drejtat civile e politike.

Koncepti i të drejtave është bërë tashmë një mjet me anën e të cilit janë kryer dhe kryhen ndryshime sinjifikative politike. Sidoqë dikush mund të sjellë arumenta se kushtet konceptuale paraprake në mbrojtje të të drejtave humane kanë egzistuar edhe më parë, hartimi i një Deklarate të plotë për të Drejtat e Njeriut u bë e mundur vetëm në shekullin e 20^{te} dhe vetëm në përgjigje dhe si reagim ndaj shkeljeve më mizore dhe të egra që iu bënë të drejtave të njeriut gjatë këtij shekulli, që u kulmuan me holokaustin nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore. Asambleja e Përgjithëshme e OKB miratoi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) në Dhjetor 1948 dhe që i drejtohej në mënyrë të posaçme nevojës për të parandaluar që shkelje të tilla mizore e të tjera të ngjashme të mos ndodhnin në të ardhmen.



DOKTRINA E TE DREJTAVE TE NJERIUT

Në vetvete Deklarata shkonte akoma më larg me përpjekje të dukshme dhe të pandërprera për të shpallur se e drejta për jetën është një e drejtë humane themelore dhe e patjetërueshme që e kanë të gjithë individët. DUDNJ është e ndërtuar nga një Preambul dhe 30 nene, të cilat identifikojnë në mënyrë të posaçme të drejta të tilla si e drejta për të mos iu nënshtruar asnjë forme të torturës (neni 5), të drejtën për azil (neni 14), të drejtën e pronës private (neni 17) dhe të drejtën për të pasur standarde të përshtatëshme jetese (neni 25) si të drejta themelore të njeriut. Kjo Deklaratë Universale u mbështet më vonë edhe me dokumenta suplement të saj sipas karakteristikave e problemeve rajonale e kontinentale si Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave Humane dhe Lirive Themelore (1953) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966).

Qëllimet dhe aspiratat e veçanta që përmbajnë këto tri dokumenta, u përforcuan me kohë edhe me një numur të koniderueshëm Deklatratash dhe Konventash të tjera. Të mara sëbashku, këto Deklarata, Konventa dhe Marrëveshje përbëjnë Doktrinën bashkohore të së Drejtës Humane, që mishëron në vetvete, edhe besimin për ekzistencën e një morali të dobishëm universal, edhe besimin për zotërimin, nga të gjitha qëniet humane, nga të gjithë individët, të të njëjtit status të barabartë themelor, që përshkon konceptin e të Drejtës Humane.

Ndërtimi i doktrinës në formën e dokumentave dhe instrumentave rregullues ndërkombëtarë, që shpesh herë, kanë edhe fuqi detyruese, bën që të Drejtat e Njeriut, të mos jenë vetëm një kornizë filozofike apo një ideologji e shoqërive të sotme demokratike, por në kënvështrimin e sotëm, të ketë më tepër një përafrim juridik ndaj Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut. Kjo Deklaratë, përbën të parën marrëveshje ndërkombëtare sekulare mbi të drejtat e njeriut dhe, sikurse përmendëm edhe më sipër, buron nga dëshira e kombeve, popujve dhe qeverive të tyre, për të parandaluar që të ndodhin sërish barbaritë dhe mizoritë e Luftës së Dytë Botërore duke vendosur “standarde të përbashkëta për t’u arritur nga të gjithë popujt dhe të gjitha kombet”.

Teksti i Deklaratës ishte dhe ka mbetur edhe sot jo-detyrues, por ai gjithashtu ruan ende forcën si autoriteti parësor për të drejtat e njeriut dhe mbështetet vazhdimisht nga veprimtaria e OKB, për të nxitur që ky dokument të inkorporohet në ligjislacionin e vendeve anëtare. Po ashtu, mjaft shpejt, në 1949, u ngrit Këshilli i Europës, si një mekanizëm institucional mbarë europian, për të nxitur në vendet anëtare të Drejtat e Njeriut, demokracinë pluraliste parlamentare dhe shtetin ligjor. Instrumenti kryesor i këtij organizmi u bë Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, që u miratua në 1950, dhe që rithekson në kushtet dhe realitetet socialpolitike europiane ato të drejta që shpili Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e OKB. Sot janë rreth 46 vende europiane që kanë aderuar dhe e kanë ratifikuar në parlamentet e tyre këtë Konventë. E veçanta e Konventës Europiane është se ndryshe nga natyra jo-detyruese që ka Deklarata Universale, konventa ka fuqi detyruese. Qysh prej fillimit të viteve '90, në paketën kushtetuese dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vitit 1998, vendin kryesor e zë shpallja e të drejtave themelore të shtetasve, detyimi për pushtetin legjislativ për t’i përfshirë këto të drejta si standarde në ligjet që miratohen, si dhe detyrimi për t’i mbrojtur dhe respektuar realisht nga zyrtarët dhe shteti shqiptar.

Gjatë një dhjetëvjeçari, mbas miratimit të Koncentës dhe Këshillit të Europës, u ngrit gjithashtu edhe një sistem i tërë juridik ndërkombëtar autoriteti, për të patur dhe marrë grancitë e duhura, që shtetet anëtare të pranojnë e të zbatojnë Konventën në praktikat e tyre të brendëshme. Në kuadrin e ndërtimit të këtij sistemi, u ngrit Komisioni Europian për të Drejtat e Njeriut, më 1954, që shqyrton ankesat që vijnë nga individët, grupet, organizatat ose shtetet e tjera dhe vendos për pranueshmërinë e tyre, para se t’ia kalojë ato për shqyrtim të mëtejshëm Komitetit të Ministrave të Këshillit të Eurpës. Komisioni dhe Komiteti kanë një afat tremujor për të paraqitur çështjen para



Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (e ngritur qysh nga viti 1959) për të marrë një vendim të formës së prerë dhe detyrues. Individët nuk lejoheshin të çonin çështjet e tyre deri në vitin 1966.

Zgjerimi i Këshillit të Europës në vitet '80 dhe '90 bëri që puna e institucioneve të Konventës Europiane të shtohet së tepërmi dhe Komisioni vetëm në vitin 1981 trajtoi 404 aplikime shqyrtimi të ankesave për shkelje të të Drejtave të Njeriut, kurse për vitin 1997 numuri i aplikimeve shkoi në 4750, ndërsa Gjykata Eurpoiane në vitin 1981 shqyrtoi vetëm 7 raste, në vitin 1997 kjo shifër u rit në 119. në vitin 1998 u vendos që gjykata të kishte një trup gjykues me kohë të plotë.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, i ndan të drejtat, në formën e saj orgjinale, qysh në 1948, në tri kategori: absolute, të kufizuara dhe të kualifikuara për kompetencë. Kështu, ndërsa e Drejta për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimeve të tjera jonjerzore, konsiderohet si një e drejtë absolute, që nuk mund të çenohet në asnjë rrethanë, të drejta të tilla si e drejta për liri dhe siguri, konsiderohen si të kufizuara, ç'ka do të thotë se ato mund të çenohen me ligjet vendore. Më tej të drejtat e kualifikuara do të ishin ato që mund të pengohen, nëse është mendohet e domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e shëndetit, moralit dhe rendit publik, ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve “.

Është e rëndësishme të theksohet se, ndonëse Doktrina e sotme e së Drejtës Humane, bazohet në thelb tek koncepti i të Drejtës Natyrore, ajo nuk është vetëm shprehje e thjeshtë e tij në kushtet e sotme, por e tejkalon atë në aspekte shumë të rëndësishme.

Mund të dallohen të paktën tri mënyra në të cilat koncepti i sotëm shkon përtej konceptit të së Drejtës Natyrore:

Së pari, të drejtat humane sipas konceptit të sotëm kanë më tepër lidhje dhe janë të fokusuar të arrihen në realizimin e tyre përmes shtrimit të kërkesave për aksione pozitive nga shteti, psh duke garantuar asistencë për mirëqënien dhe ndihmën sociale çdo qytetar. Përkrahësit e të dejtave natyrore nga ana tjetër tregoheshin më të prirur për ta parë barazinë në terma formalë, si kërkesa themelore ndaj shtetit për t'iu shmangur “ndërhyrjes” së tij në jetët e individëve.

Së dyti ndërsa përkrahësit e të drejtës natyrore priren më tepër t'i shohin dhe pranojnë individët si më tepër individualë, si “ishuj të vërtetë në vetvete”, përkrahja e të drejtave humane sipas konceptit të sotëm do të çonte në një zgjerim të vullnetit për pranuar rolin e rëndësishëm të familjes dhe të komunitetit në jetën e individëve.

Së treti, të drejtat e sotme të njeriut janë më tepër ndërkombëtare për nga qëllimi dhe pirjet sesa ishin në kohën kur ato u formuluan mbi argumentat që rridhnin nga të drejtat natyrore. Kjo do të thotë se mbrojtja dhe nxitja e respektimit të të drejtave humane janë parë vazhdimisht dhe në mënyrë progresive si një kërkesë për veprime dhe shqetësime me një inters ndërkombëtar.

Dallimi midis të drejtave humane dhe të drejtave natyrore jep mundësi për këdo të njohë se si ka evoluar koncepti rreth të Drejtave të Njeriut. Natyrisht, ka një numur të konsiderueshëm studiuesish që arrijnë në përfundimin se ka tri gjenerata të të Drejtave të Njeriut, të formuluar dhe përsosura në kohë dhe periudha të ndryshme socialpolitike dhe historike. Gjenerata e parë përbëhet nga të drejtat për siguri, pronë dhe pjesëmarrje politike. Këto janë të drejtat mbi të cilat, në mënyrë tipike përqëndrohen Deklaratat franceze dhe amerikane. Gjenerata e dytë e të drejtave është ajo që fokusohet mbi të drejtat socialekonomike, e drejta për përkrahje sociale dhe



mirëqënie, për arsim dhe argëtim. Këto të drejta gjenden gjerësisht të trajtuara dhe shpallura tek DUDNJ. Gjenerata e tretë dhe e fundit e të drejtave ndërtohet mbi të drejtat të tilla si e Drejta e kombeve për vetvendosje, e drejta për një mjedis të çpastër dhe të drejtat e minoriteteve.

Kjo gjenratë është shpallur dhe vendosur gjatë dy dekadave të fundit të shekullit të 20^{ës} dhe përfaqëson një zhvillim domethënës në doktrinën e të Drejtve Humane në përgjithësi.

11

Ndërkohë, që të drejtat e njeriut marrin domethënie e realizim të plotë vetëm duke u bërë përfundimisht të qarta për disa njerëz, që kanë pushtetin e duhur t'i nxisin dhe mbrojnë ato, vetë koncepti ka një histori që shtrihet në një hapësirë dyqintvjeçare. Përpunimi i një koncepti të tillë u nënvizua nga shfaqja dhe asimilimi i një numuri doktrinash dhe idesh filozofike e morale dhe arriti kulmet e veta me hartimin dhe miratimin e një strukture mjaft komplekse dokumentash dhe institucionesh ligjore e politike, që shprehnin dhe fokusoheshin në thelbin e tyre tek qëllimi i mbrojtjes, përhapjes dhe nxitjes të të Drejtave Themelore për të gjithë individët kudoqofshin. Do të ishin shumë të pakët njerzit që do të nënvleftësonin rëndësinë e kësaj faqe të veçantë të historisë njerzore.

Një analizë filozofike e konceptit të të drejtave humane

Të Drejtat Humane janë ato që i bashkëngjiten qënieve njerëzore dhe funksionojnë si garanci morale në mbështetje të kërkesave për të pasur një minimum jetese të mirë. Në terma konceptuale, të Drejtat Humane e kanë në vetvete rrjedhin nga koncepti i së Drejtës. Vendosja e theksit në analizën filozofike të këtij koncepti të së Drejtës na qartëson cilat janë pjesët e ndryshme përbërëse të tij, të cilat qëndrojnë në themelin e të drejtave humane. Për të arritur një gjë të tillë është e nevojshme të arrihet një kuptim i plotë dhe i qartë edhe për themelet filozofike të doktrinës të të Drejtave Humane, edhe të mënyrave të ndryshme në të cilat funksionojnë të drejta të veçanta të njeriut.

□ E drejta morale dhe e drejta juridike

Dallimi që bëhet midis të Drejtës morale dhe asaj ligjore, si dy kategori të veçanta të së Drejtës ka rëndësi themelore në të kuptuarin e bazave dhe aplikimeve të mundëshme të të Drejtave të Njeriut. E drejta ligjore ka të bëjë me të gjitha ato të drejta që gjenden të inkorporuara në mënyrë eksplicite apo të nënkuptuar brenda kodeve ligjore egzistuesë, si në kodet penale edhe në ato civilë. Në këtë mënyrë, një e drejtë ligjore quhet ajo që njihet dhe mbrohet me ligj. Konstatimi i ekzistencës së saj mund të bëhet thjesht duke gjetur instrumentin ligjor përkatës ose pjesën e legjislacionit ku ajo ndodhet. Kjo lloj e drejte nuk mund të egzistojë më përpara se ajo të përfshihet ose të pasqyrohet në ligje dhe kufijtë e vleftshmërisë së saj përcaktohen nga juridiksioni i organizmit, që miraton ligjet ose normat juridike. Shëmbull i kësaj mund të jetë rasti kur një qytetar shqiptar, që sipas kushtetutës, gëzon të drejtën për të marrë arsimim të përshtatshëm, të drejtën e votës apo të drejtën e pronës private, nuk mund t'i gëzojë plotësisht apo pjesërisht këto të drejta në Greqi, në Itali, apo gjetkë ku ndodhet si emigrant ekonomik ilegal, nëse ligji i atij vendi nuk parashikon realizimin e tyre për ata që nuk janë shtetas. Këto të drejta kanë limite realizimi brenda territorit të shtetit dhe për shtetasit.

Mendimtarët e Pozitivizmit Ligjor, argumentojnë se vetëm të drejtat, të cilave u përmëndet me ligj egzistenca, janë të drejta ligjore, si të drejta që e kanë burimin apo rrjedhin nga brenda sistemit ligjor aktual. Sipas kësaj pikpamje, të drejtat morale, në një sens të ngushtë, nuk janë medoemos të drejta ligjore; por ato menohen më tepër si kërkesa e pohime morale, që mundet ose jo të merren në konsiderate nga ligjet ndërkombëtarë apo vendas. Sidoqë kritika e tyre drejtohej kundrejt tezës filozofike mbi të drejtat natyrore, indirekt ato drejtohen edhe ndaj konceptit të



sotëm të së Drejtës humane. Për një pozitivist ligjor, si Jeremy Bentham⁷ (filozof anglez i pozitivizmit ligjor i shekullit 19^{te}), nuk mund të ketë të drejta, të tilla si të Drejtat e Njeriut, që të egzistojnë më përpara ose në mënyrë të pavarur nga kodifikimi ligjor. Për ta, përcaktimi i egzistencës të së Drejtës nuk është më tepër i ndërlikuar sesa përcaktimi i vendndodhjes së saj në ligje apo kode ligjore. Duke qëndruar në pozitivat e pozitivizmit ligjor, Tibor Machan, e kundërshton nocionin e “të drejtës së re pozitive” të disa politologëve të sotëm:

12

... ajo është një tjetër truk mjaft i suksesëshëm gjuhësor, njëlloj me atë që shfrytëzon konceptin e respektuar të “Liberalizmit”. Është po e njëjta alkimi që e shndëron floririn në plumb. “Liberalizmi” përdoret për të cilësuar filozofinë që mbështet të drejtat dhe liritë individuale. Sot, në zhargonin e ditës, ai shpesh nënkupton të kundërtën: një ideologji që rekomandon shkeljen sistematike të lirisë, për hir të rishpërndarjes të të mirave, ndryshe nga ajo që aplikohet në shoqëri... Ashtu si në rastin e “liberalizmit të ri” që është një liberalizëm fallso, edhe “të drejtat e reja pozitive” janë të drejta fallso. Në secilin rast, thelbi i vleftshëmërisë dhe dobisë së parimit dëmtohet...

... Të Drejtat Pozitive, kërkojnë që ne të jemi të garantuar për disa të mira ose shërbime me çmimin e personave të tjerë, që mund të plotësohen vetëm përmes një shtrëngimi sistematik. Kjo ide, njihet edhe me emrin “Doktrina e posedimit të së Drejtës”, e cila nënkupton se vetëm disa njerëzve t’u jepen në posedim ato drejta, që i meritojnë edhe njerëz të tjerë. Kjo sepse qëniet humane, nga natyra e tyre janë të detyruar, si objekt i detyrimit shtrëngues, pjesërisht ose tërësisht të bashkëjetojnë me persona të tjerë. Në këtë kuptim zëmërgjerësia, bujaria dhe bamirësia nuk mund t’i lihen në dorë vetdijes individuale. Nëse njerëzit kanë të drejta të tilla pozitive, askush nuk mund të justifikohet për të refuzuar shërbimet që duhet tu japë të tjerëve, çdonjeri mund të thirret për të shërbyer pavarësisht nga zgjedhjet dhe qëllimet e veta individuale.⁸

Në kontrast me të Drejtën ligjore, e Drejta morale që shpallet ose pretendohet, egziston pavarësisht dhe që më parë në raport me të drejtat ligjore homologe. Egzistenca dhe vleftshmëria e të drejtës morale nuk mendohet të jetë e ndërvaur nga veprimet apo aktet ligjore që nxjerrin juristët dhe ligjvënësit. Mjaft njerëz do të argumentojnë se, psh në periudhën komuniste të gjithë shtetasit, edhe ata me qëndrime politike disidente apo të persekutuar nga rregjimi e gëzonin të drejtën morale për të qënë plotësisht pjesëmarrës në sistemin politik, megjithëse realisht për ta nuk kishte asnjë të drejtë të tillë ligjore, madje edhe kur flitej për to, kategori të tilla konsideroheshin të përjashtuara nga jeta politike. Kjo ishte edhe arsyeja që shumica e njerëzve e kundërshtuan rregjimin, sidomos në lëvizjen studentore të Dhjetorit 1990 i formuluan kërkesat e tyre për ndryshim dhe opozicionin e tyre politik pikërisht në termat e të Drejtave humane. Ajo që u konsiderua si më e neveritëshme dhe çnjerëzore për periudhën komuniste të Shqipërisë ishte pikërisht mohimi i një numuri të konsiderueshëm të Drejtash Themelore të Njeriut, veçanërisht të drejtat për lirinë e opinionit dhe fjalës, të drejtën e prezumimit të pafajsisë dhe të barazisë para ligjit, të drejtën për një gjykim të paanshëm, lirinë e besimit, lirinë e tubimeve etj.

Kjo linjë specifike e opozicionit ndaj regjimit dhe e protestës mund të ndiqet vetëm kur besohet në egzistencën dhe vleftshmërinë e të drejtave morale. Besimi se të drejtat themelore, të cilat mund të kenë ose të mos kenë miratimin ligjor diku apo nga dikush, mbeten sërish plotësisht të padiskutueshme për nga vlera dhe madje nga për nga imponimi moral, veçanërisht në ato vende ku mungon njohja e tyre nga sistemi ligjor për këto të drejta. Një opozicion ndaj regjimeve totalitare, si ato që u zhvilluan në vendet e Europës lindore dhe në Shqipëri, në vitet '90, nuk mund të fillonte dhe të mbahej në këmbë mbi bazën e të drejtave ligjore, për arsye që kuptohen lehtë e qartë. Askush nuk do të mund të argumentonte në mënyrë ligjore faktin se të drejtat



themelore të njeriut shkeleshin nga regjimet totalitare, përderisa ato nuk egzistonin si të tilla në asnjë nga ligjet e kohës, madje as nëpër kushtetuta. Mohimi sistematik i të drejtave të tilla, megjithatë, përbënte një shkelje flagrante të të drejtave themelore morale të këtyre njerzve.

Nga shëmbulli, duket qartë se të drejtat humane nuk mund të reduktohen, ose të identifikohen vetëm me të drejtat ligjore. Pozicioni i pozitivizmit ligjor përjashton mundësinë e dënimit të sistemeve të tilla politike, si sistemet totalitare apo ato të aparteidit ndaj popujve nga këndvështrimi i së drejtës. Kjo forcon, për rrjedhojë, joshjen tunduese për t'i trajtuar dhe identifikuar të drejtat humane si të drejta morale. Për më tepër, egzistenca e DUDNJ, e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe një numur marrëveshjesh e konventash të tjera ndërkombëtare, për të cilat Shqipëria dhe vendet e lindjes europiane nuk ishin palë nënshkruese në mjaft raste, i pajisi lëvizjet socialpolitike opozitare kundër totalitarizmit të viteve '90, me argumenta të fuqishëm moralë. Nuk ishte rastësi që të gjitha forcat opozitare në Shqipëri, më tepër sesa tek kritika e kërkesa për të përmbytur regjimin, e vendosën theksin tek njohja dhe respektimi i të Drejtave Themelore të Njeriut. Dokumentat e para ndërkombëtare, të cilat u nënshkruan nga qeverisjet postkomuniste të mbas viteve '90, ishin pikërisht "Akti Final" i KSBE, apo "Marrëveshja e Helsinkit", Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ndryshimet në legjislacionin shqiptar nisën pikërisht me shpalljen e pranimin e të drejtave e lirive kushtetuese të shtetasve.

Të Drejtat Humane kanë të përbashkët një pjesë shumë esenciale të së drejtës morale, që do të thotë se ato nuk konsiderohen dhe nuk mund të mendohen si të kushtëzuara nga qënia e tyre e pranuar apo jo ligjërisht. Ato janë të destinuara për t'u aplikuar për të gjitha qeniet njerzore, kurdoherë e kudoqofshin, pavarësisht nëse ato kanë apo nuk kanë njohje dhe miratim ligjor nga shtetet. Universaliteti i tyre, si të drejtat morale të një shoqërie demokratike i bën një forcë të dukshme progresiste. Megjithatë, për rolin që kanë në shoqëri, të drejtat ligjore nuk i hedhin poshtë dhe nuk e kundërshtojnë egzistencën e bazueshmërinë që kanë të drejtat morale. Të Drejtat e Njeriut janë njëkohësisht, (për shkak të mënyrës si janë konceptuar, shpallur e miratuar në formën e dokumentave dhe instrumentave ndërkombëtarë që i administrojnë) janë edhe të drejta ligjore, edhe të drejta morale. Ato lindin si të drejta morale dhe legjitimiteti i tyre varet në mënyrë të domosdoshme nga legjitimiteti i konceptit të së drejtave morale. Për këtë arsye, qëllimi dhe objektivi parësor i përkrahësve të të Drejtave të Njeriut ka qënë dhe është që ato të marrin miratim ligjor universal. Në pikpamje praktike, të aplikimit në jetën reale, këto të drejta, sado universale dhe të përligjura të jenë si të drejta morale, kanë nevojë që të inkuadrohen dhe të përfshihen brenda të drejtave ligjore.

□ Të Drejtat e deklaruarat dhe të Drejtat e lirisë

Për të arritur një kuptim të qartë rreth tipareve themelore të të Drejtave të Njeriut, ashtu siç kuptohen ato sot, është e nevojshme të shihet më në hollësi dallimi që kanë të drejtat e deklaruarat me të drejtat e lirisë. Duhet theksuar se kjo ka lidhje me diskutimin për traditën që i referohet pikpamjeve të W.N. Hohfeld (1919) lidhur me një klasifikim më të zgjeruar të tij të të drejtave. Ai vren katër kategori të drejtash: të drejtat e lirisë, të drejtat e deklaruarat, të drejtat e pushtetit dhe të drejtat e imunitetit. Studiuesit e sotëm kanë prirjen të përfshijnë dy të fundit me të parën dhe për këtë arsye i kushtojnë më tepër vëmendje krahasimit midis të drejtave të lirisë dhe atyre të deklaruarat. Politologu Peter Jones (1994) përbën një shëmbull.

Jones e ngushton fokusin e vet në dallimin midis këtyre dy kategorive, duke iu përshtatur prirjes të pranuar tashmë gjerësisht, që i sheh të dyja të drejtat të një rëndësie parësore. Ai e përkufizon të drejtën e deklaruarat si të përbërë nga detyrime të qenieve humane ndaj një detyre. E drejtë e deklaruarat është ajo që ka një person kundrejt personave të tjerë, të



cilët kanë një detyrë korresponduese në ngarkim për t'ia respektuar. Pra, nëse dikush gëzon të drejtën të marrë arsimim të përshtatëshëm ose të konsiderohet i pafajshëm deri sa nuk ka për të një vendim gjyqi të formës së prerë, kjo është një e drejtë e deklaruar përballë instirucioneve arsimore ose të zbatimit të ligjit, të cilët kanë detyrën t'i garantojnë plotësimin e kësaj të drejte, pavarësisht nga dëshira apo vullneti i tij.

14

Jones, më tej, vëren një nëndarje brenda konceptit të së drejtës së deklaruar, kur veçon të drejtat e deklaruara pozitive nga të drejtat e deklarura negative. Kështu ndërsa për të drejtën e një arsimimi të përshtatëshëm, dikush e ka për të përfituar një të mirë ose shërbim të posaçëm, në këtë rast ai ka një të drejtë të deklaruar pozitive; përkundrazi, të drejtat e deklaruara negative, janë të drejta që dikush i gëzon kur të tjerët nuk ndërhyjnë në jetën e tij private, nuk e paragjykojnë duke e konsideruar fajtor pa pasur një vendim gjyqi të formës së prerë, nuk i vjedhin pronën, ose nuk i fyejnë dinjitetin e tij. Duke iu referuar shëmbullit të sjellë më sipër nga raporti vjetor 2005 i FNH, vëmë re se kemi të bëjmë pikërisht me cënimin e një të drejte të deklaruar negative të çdo qytetari, kundrejt të gjitha organeve të zbatimit të ligjit, të cilat kanë detyrimin ta garantojnë këtë të drejtë specifike. Këto shëmbuj të tillë çojnë edhe në një nëndarje tjetër të Jones, kur brenda konceptit të së drejtës së deklaruar identifikon: të drejtat që zotërohen “in personam” dhe të drejtat që zotërohen “in rem”.

Të drejtat që zotërohen “in personam” janë ato që një individ i ka përballë disa detyrëmbajtësve specifikë, si psh autoritetet e arsimimit, ose të zbatimit të ligjit. Përkundër kësaj, të drejtat që zotërohen “in rem” do të ishin ato të drejta që çdo individ i gëzon përballë të gjithë të tjerëve që kanë për detyrë t'ia garantojnë atë, psh e drejta e jetës, e pronës private, e drejta për të mos i cënuar nderin dhe dinjitetin, e drejta e privacisë. Në të drejtat “in rem”, të gjithë individët kanë për detyrë t'ia respektojnë ato njeri-tjetrit. Të drejtat e deklaruara, për pasojë, mund të jenë pozitive ose negative dhe gjithashtu mund të zotërohen ose “in personam”, ose “in rem”.

Peter Jones flet edhe për të drejtat e lirisë, të cilat, sipas tij, janë ato që egzistojnë në mungesë të çdo detyrimi për të bërë ose mos bërë veprimet që dëshiron dhe ndaj tyre askush nuk ka për detyrë të kujdeset, të veprojë ose kundërveprojë për t'i realizuar. Ndryshe nga të drejtat e deklaruara, të drejtat e lirisë në karakterin e tyre janë kryesisht negative. Psh, nëse dikush vendos t'i kalojë pushimet e veta në ndonjë nga plazhet e bukura të bregdetit apo diku gjetkë, vendimi për të veshur xhakët dhe jo pardesy për ditën e sotme, mund të themi që gëzon një të drejtë të lirisë. Për fat të keq, nuk egziston askush që të ketë për detyrë për të garantuar pozitivisht që të realizohet kjo e drejtë e lirisë. Pikërisht, për këtë arsye ajo në karakter është negative, sepse nëse dikush që e ka një dëshirë të tillë, por nuk mund ta realizojë për shkak të kushteve të veta financiare, ajo mbetet e penguar. Psh, nuk ka asnjë autoritet apo organ, ekuivalent me autoritetet arimore ose të zbatimit të ligjit, që të kenë përgjegjësinë ose detyrimin t'i garantojnë plotësimin e kësaj ëndre. Të drejtat e lirisë, mund të thuhet se janë të drejtat për të bërë siç i përqen dikujt, pikërisht sepse nuk ka asnjë detyrim, bazuar në të tjera të drejta të deklaruara, që ta përmbajnë ose shmangin nga të vepruarit në këtë mënyrë. Të drejtat e lirisë garantojnë mundësi dhe aftësi për të qënë i lirë, pa pasur nevojën e mjeteve specifike për të ndjekur një qëllim dhe objektivat e vullnetit personal.

Kategoritë e pavarura të Drejtave të Njeriut

Më sipër, theksi i shqyrtimit mbi të Drejtat e Njeriut, u vendos në analizën e tyre nga pikpamja e “cilësive të formës”. Por, është e nevojshme që ato të shihen dhe analizohen edhe në kategorizimin e tyre sipas thelbit dhe rëndësisë. Nëse do të bënim një shqyrtim të të gjithë dokumentave dhe instrumentave, të cilët formojnë sëbashku kurmin e kodifikuar të të Drejtave të



DOKTRINA E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Njeriut, do të vinim re një klasifikim të pesë kategorive bazë të të Drejtave të Njeriut, pavarura për nga thelbi i tyre: 1. të drejtat për jetën; 2. të drejtat për të qenë i lirë; 3. të drejtat për pjesëmarrje politike; 4. të drejtat për mbrojtje në shtetin ligjor; 5. të drejtat për të gëzuar të mirat themelore sociale, ekonomike e kulturore.

Këto pesë kategori të drejtash qarkojnë rreth vetes të tri gjenratat e të Drejtave të Njeriut, që përmendëm më sipër, dhe ndërtohen si një kombinim kompleks i të drejtave të deklaruara me të drejtat e lirisë. Disa të drejta, si psh të drejtat për jetën, përbëhen edhe nga të drejta të deklaruara edhe nga të drejta të lirisë në një masë gati të barabartë. Kështu, një mbrojtje e përshtatëshme e jetës kërkon njëllor edhe egzistencën e të drejtës së lirisë së individit për të mos u fyer, lënduar e penguar nga individët e tjerë, edhe egzistencën e të drejtës së deklaruar për të pasur akses të përshtatshëm tek parakushtet themelore në mbështetje të jetës së individit si diçka e përshtatëshme, kujdesi shëndetësor dhe mbrojtja ligjore e jetës.

Të drejta të tjera si ato ekonomike, sociale dhe kulturore, i rëndojnë më tepër në drejtim të egzistencës së atyre të drejtave të deklaruara, të cilat kërkojnë dispozita e kushte pozitive për të synuar dhe arritur objektivin e tyre. Shqyrtimi dhe bërja e dallimeve sipas rëndësisë midis të drejtave të njeriut mund të hasë në kundërshtime dhe mund të ngjallë diskutime, por nga ana tjetër ka pasoja të rëndësishme. Brenda kësaj rëndësie mund përfshihet, psh diskutimi rreth mbajtjes apo i heqjes së dënimit kapital.

Të Drejtat e Njeriut në përgjithësi janë konsideruar dhe konsiderohen të kenë vlerë të barabartë, çdo e drejtë konceptohet dhe përfytyrohet e të njëjtës rëndësi me të tjerat. Në këtë këndvështrim, nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë potencial për konflikte midis të drejtave themelore. Çdonjera prej tyre zotëron të njëjtën peshë morale, sa edhe të tjerat. Kjo pengon që të drejtat e njeriut të renditen e të zgjidhen sipas rregullit të rëndësisë së tyre. Megjithatë, rënie ndesh e mospërputhje në pikpamje të rëndësisë midis tyre mund të ketë dhe në realitet ndodh.. Trajtimi i të gjitha të drejtave të njeriut me këndvështrimin e rëndësisë së barabartë, do të pengonte që të zgjidheshin mospërputhjet që lindin. Për ta bërë më të qartë këtë pikpamje, le të marrim si shëmbull një vend hipotetik në zhvillim, i cili ka kufizime e mungesa të shumta në burime financiare e materjale. Një vend i tillë do të ishte i paaftë të garantonte burimet e nevojshme për të realizuar të gjitha të drejtat humane për të gjithë qytetarët e tij, ndonëse ai është i angazhuar plotësisht për ta bërë këtë gjë. Ndërkohë, zyrtarët qeverisës, duan të dinë se cilat nga të drejtat humane janë më absolute nga të tjerat, cilat nga të drejtat themelore duhen vënë në krye të listës së prioriteteve imediate qeverisëse, për të kërkuar pastaj mjetet e duhura të garantimit të tyre? Këtyre pyetjeve, nuk mund t'i jepet një përgjigje, nëse ngulmohet në pozicionin se të gjitha të drejtat kanë të njëjtën rëndësi. Ndërkohëqë përgjigja vjen kur jepet mundësia për të listuar disa nga të drejtat themelore si më të rëndësishmet, si dhe veprimet moralisht korrekte, që duhet të ndërmarrë qeverisja për të përcaktuar prioritetet.

Hezitimi për të bërë këtë klasifikim prioriteteve, nuk ka të bëjë me faktin se kjo do të dukej filozofikisht dogmatike, por me faktin se bërja e dallimeve të tilla midis të drejtave themelore të njeriut, në të vërtetë përbën një detyrë mjaft të tensionuar filozofike. Është e qartë se kjo kërkon përcaktimin e disa kriterëve paraprake bazë, mbi të cilat do të bëhet "matja" e rëndësisë relative të të drejtave të veçanta të njeriut. Kjo në të vërtetë, është një çështje shumë e diskutueshme në filozofinë e të drejtave humane, që duket më qartë në përpjekjet e bëra nga filozofë të shumtë për të vërtetuar e shpjeguar doktrinën e të drejtave humane. Ajo që mbetet në çështjen nëse duhet apo jo të bëhet një klasifikim relativ i rëndësisë së të drejtave, është se cili do të ishte instrumti më i përshtatshëm që do të vinte në jetë të drejtat njerzore në përgjithësi, kush do ta merte



përsipër një detyrë të tillë, kush do të kishte përgjegjësinë për të mbrojtur dhe nxitur të drejtat e njeriut dhe çfarë kërkohet prej tij për ta bërë një gjë të tillë?

□ Kufijtë e detyrave për të drejtat e njeriut

“Të drejtat themelore të individit janë pronë e çdo njeriu”. Një nga konkluzionet tradicionale të këtij pohimi është se të gjithë individët kanë për detyrë të mbrojnë dhe respektojnë të drejtat e njeri tjetrit.

Megjithatë në praktikë, barra për të garantuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut bie mbi grupe të caktuara qeverisëse, në nivel vendor apo ndërkombëtar si dhe në organe ndërqeveritare. Thomas Pogge (1995) argumenton se përgjegjësia morale për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut duhet të mos bjerë në mënyrë simetrike mbi institucione të tilla, dhe vetëm për faktin se ato janë të organizuara më mirë dhe janë më të aftat për t'i përmbushur me efektivitet këto detyra. Në këtë pikpamje, organizatat joqeveritare dhe qytetarët privatë kanë e duhet të luajnë një rol më të rëndësishëm në mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por megjithatë barra duhet të bjerë mbi institucionet qeverisëse vendore e ndërkombëtare.

Pogge fokusohet tek shqetësimi për “privatizimin” e të drejtave të njeriut, sepse prej tij mund të injorohen dy faktorë veçanërisht të spikatur: 1. individualët që kanë prirjen të përcaktojnë si prioritare kërkesat morale më afër tyre, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me pjestarët e familjes apo komuniteteve ku jetojnë; dhe 2. aftësitë e individëve për të përmbushur detyrat e tyre, të determinuar në masë të madhe, nga rrethanat e veta financiare. Për pasojë, pabarazitë globale në shpërndarjen e të mirave materjale minojnë në themele aftësitë e atyre që jetojnë në vendet e varfëra për të shkëmbyer reciprokisht ndihmën që u vjen atyre nga vendet më të pasura. Arsye si këto, që nënvizon Pogge, këmbëngulin që pesha e përgjegjësisë të mbetet në nivelin e organizmave vendorë e ndërkombëtarë. Mbrojtja dhe respektimi i mjaftueshëm i të drejtave të njeriut kërkon edhe garantimin e shërbimeve të përshtatëshme nga shteti për qytetarët e vet, edhe bashkëpunimin midis shteteve, në kuadrin e institucioneve ndërkombëtare, që veprojnë për të garantuar kushtet globale të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave themelore të individit.

Çfarë duhet të bëjnë këto organizma gjatë aktivitetit të tyre, për të garantuar të drejtat e individëve? A duhet që për të marrë një arsimim të përshtatëshëm të kërkohet nga autoritetet arsimore të bëjnë çdo gjë të mundëshme për të mbështetur e përmirësuar arsimimin e fëmijëve? A duhet tu kërkohet që të krijojnë kushtet e një biblioteke të klasit botëror, udhëtime të rregullta stimore jashtë vendit dhe të punësojnë mësuesit më të aftë e më të kualifikuar? Përgjigja do të ishte padyshim, JO. Pamjaftueshmëritë relative në burime të tilla dhe kërkesat ndaj këtyre burimeve, na shtyn të mendojmë se garantimi i përshtatëshëm i të drejtave themelore të individit, shtrën nevojën për krijimin e praktikave të përshtatëshme sociale dhe qeverisëse, deri në atë masë sa të garantohet minimumi i mundësive për një minimum jetese të mirë.

Në radhë të parë, qeverisjet vendore, janë mbi të gjitha përgjegjëse për garantimin e një niveli të pranueshëm të respektimit të të drejtave për shtetsit e vet. Brian Orend (2002) e vërteton këtë aspiratë kur shkruan se objekti i të drejtave humane është të garantohet “një nivel minimal i trajtimit të përshtatëshëm dhe pranueshëm” është e rëndësishme të theksohet se detyrimi për të garantuar një trajtim të tillë në një nivel minimal pranueshmërie dhe përshtatshmërie nuk mund të kufizohet vetëm brenda kufijve kombëtarë.

Mbrojtja, garantimi dhe nxitja e të drejtave të individit për çdo njeri, do të kërkonte më tepër ndihmë nga shtetet më të pasura e më të fuqishme ndaj vendeve që aktualisht janë të paafta ta garantojnë atë me burimet e tyre të brendëshme. Ndonëse, disa mund t'i konsiderojnë aspiratat e



B. Orend për të drejtat humane si tepër të matura, ndoshta vëzhgimi më i shpejtë i gjeografisë së vuajtjeve dhe deprivimeve njerëzore që ekzistojnë në mjaft pjesë të botës së sotme, pavarësisht nga sitemet ekonomike e socialpolitike të tyre, tregon se sa larg jemi ende nga realizimi i standardit të vërtetë minimal.

Realizimi i këtyre standardeve për kushte minimale për të gjitha qëniet humane, nuk duhet ngatërruar me përpjekjet për një shoqëri moralisht të përsosur. Përshtypja se mos të drejtat humane janë tepër utopike për tu realizuar realisht, dhe që shpesh krijohet nga pengesat dhe pamjaftueshmëritë e panumurta që ekzistojnë në praktikë, provon më së paku problemet e brendshme në të drejtat e individit dhe më së shumti se hapsirat në të cilat shtrihen aspiratat realisht modeste janë shumë larg të qenit të realizueshme në ditët e sotme.

17

Përligja filozofike e të drejtave humane

Sidoqë tashmë është vërtetuar se të drejtat e njeriut e kanë origjinën e tyre si të drejta morale, shndërimi dhe përfshirja e mjaft prej tyre në legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar, çon në përfundimin se në shumicën e rasteve, ato janë edhe të drejta morale edhe të drejta ligjore. Veç kësaj, të drejtat e njeriut mund të jenë ose të deklaruara ose të drejta të lirisë dhe kanë ngjyrimet pozitive ose negative në raport me obligimin për t'iu imponuar të tjerëve që t'i respektojnë. Ato gjithashtu ndahen në pesë kategori të veçanta dhe qëllimi parësor i garantimit të tyre është krijimi i kushteve që të gjithë individët të kenë mundësi për një minimum jetese të pranueshëm.

Duke folur në përgjithësi, studiuesit bien në një mendje për çështje të tilla si ato lidhur me cilësitë dhe tiparet formale, të objektit, forcës dhe imponueshmërinë e të drejtave të njeriut. Por kur vjen fjala për çështje të tilla themelore si ajo e përligjes dhe argumentimit filozofik e shkencor të këtyre të drejtave ka mjaft diskutime e marrëveshje. Duhet me qenë i paanëshëm për të thënë se ka mjaft përgjigje të ndryshme, madje disa herë konfliktuale për këtë çështje. Përpjekjet kryesore përqëndrohen për t'i argumentuar të drejtat humane duke i referuar idealeve të veçanta, si barabartësia, autonomia, dinjiteti njerëzor, interesat themelore humane, zotësia për të ndërtuar agjensi të arsyeshme dhe demokracia.

Argumentat në mbështetje të bazueshmërisë dhe vleftshmërisë së çdo doktrine morale nuk mund të përcaktohen vetëm e thjesht duke i referuar eksperiencave empirike të besimeve ose koncepteve morale të veçanta. Moraliteti ka lidhje themelore me atë se si duhet të jetë një çështje në të vërtetë dhe jo se si mund të rregullohet ajo sipas joshjeve e thirrjeve që bëhen lidhur me të, apo si perceptohet ajo nga njeri dhe tjetri. Si një doktrinë morale, të drejtat e njeriut duhet të tregohen se janë të bazuara dhe të vleftshëm si norma dhe jo si fakte. Me qëllim që të arrihet kjo gjë, na duhet t'i rikthehemi filozofisë së moralit. Në kohët e sotme, ka së paku tri këndvështrime teorike mbizotëruese që i adresohen çështjes së bazueshmërisë dhe dobishmërisë të të Drejtave humane: këto drejtime përafërsisht mund të përcaktohen si këndvështrimet e “teorive të interesit”, “teoritë e vullnetit” dhe “teoritë sociologjike”.

□ Kënvështrimi i teorive të interesit

Përkrahësit e këtij këndvështrimi argumentojnë se funksioni parësor i të drejtave humane është mbrojtja dhe përkrahja e disa intersave njerëzore esenciale. Garantimi i plotësisht të këtyre interesave esenciale përbën sfondin parësor bazë në të cilin të drejtat humane mund të shpjegohen dhe vërtetohen moralisht. Sipas këtij këndvështrimi më e rëndësishmja është gjetja e identifikimi i atyre parakushteve sociale dhe biologjike për të gjitha qëniet humane që ato të kenë së paku kushtet minimale të një jetese të pranueshme.



Universaliteti i këtyre të drejtave përbën një sfond e terren tjetër ku mund të fokusohet interesi i teorisë për të përcaktuar bazën mbi të cilën duhen vlerëuar disa nga të drejtat themelore, të domosdoshme sitribute të mirëqënies humane, të cilat konsiderohen të si të nevojshme për të gjithë qëniet njerzore. Marrim si shëmbull interesin e gjithësecilit për të garantuar sigurinë personale. Që kjo është një atribut themelor dhe e domosdoshme, mjafton të sjellim ndërmend praktikën historike të shoqërisë njerzore, që dëshmon qartë se njerzit gjithmonë kanë qënë të detyruar të marrin masa për të garantuar sigurinë e tyre personale, të familjes apo komunitetit të tyre.

Rruga që ka përshkuar njeriu në përpjekjet për të gjetur mënyrat më efikase të mbrojtjes së vetes dhe të pronës, përbën një nga momentet më interesante dhe impresionuese të historisë. Qysh nga kohët më të lashta faraonike, gjer në ditët e sotme, pavarisht si janë quajtur dhe mënyrat e veprimit të tyre, janë dashur gjithmonë grupe njerëzish, që të merren me kontrollin e zbatimit të normave dhe ligjeve të shoqërisë.

Gjurmët e këtyre përpjekjeve gjenden në çdo shoqëri të organizuar; në sistemet e tyre të rregullave, normave, ligjeve e zakoneve, që synojnë mbrojtjen e rendit dhe qetësisë. 9

Ky interes shërben si baza e pretendimeve tona për të kërkuar të respektohet si e drejtë e gjithkujt. Realizimi i tij mund të kërkojë të pasohet nga të tjera të drejta, si parakushte të sigurisë, si psh plotësimi i kënaqëshëm i nevojave për ushqim, nevojën për të qënë i lirë nga ndalimi dhe arrestimi arbitrar, të drejtën e jetës, të drejtën e një gjyqi të pavarur dhe të paanshëm, të drejtën e mbrojtjes ligjore, të drejtën e prezumimit të pafajësisë etj.

Finnis (1980) na sjell një nga prezantimet më të mira të këndvështrimit të “teorive të interesi”. Ai argumenton se të drejtat e njeriut janë të shpjgueshme në bazë të vlerës së tyre instrumentale për garntimin e kushteve të domosdoshme të mirëqënies humane. Për këtë, Finnis dallon shtatë lloj interesash themelore, ose siç i quan ai “forma bazë të së mirës njerzore”, që përbëjnë themelet e të drejtave të njeriut: 1). jeta dhe kapaciteti i saj për zhvillim; 2). zotërimi i njohurive, si qëllim në vetvete; 3). veprimi, si kapacitet për argëtim; 4). kënaqësia dhe shprehja estetike; 5). të qënë i shoqërueshëm dhe miqësia; 6). zgjuarsia dhe pjekuria praktike, si kapacitet për të pasur procese të menduari dhe vendimmarrje inteligjente dhe të arsyeshme; 7). dhe së fundi feja, ose kapaciteti për të pasur eksperienca shpirtërore. Sipas tij, këto janë parakushte themelore dhe, si të tilla, shërbejnë për të argumentuar e shpjeguar pretendimet e çdo qenie humane për të drejtat përkatëse, edhe kur ato janë të drejta të deklaruara, edhe kur janë të drejta të lirisë.

Të tjerë studiuesë që përkrahin të drejtat humane nga këndvështrimi i bazës së tyre të interesave, i drejtohen trajtimit të çështjes për të shpjeguar se vënia e theksit tek interesat na pajis me argumenta që vërtetojnë nevojën për respektimin dhe, kur është e domosdoshme, ndërmarrjen e veprimeve positive për të nxitur interesat e të tjerëve. Një përpjekje e tillë ka një bazë tradicionale të filozofisë morale e politike që fillon me pikpamjet e Thomas Hobbes në shekullin e 17^{te}. Sot, ky këndvështrim vihet re tek argumentat që sjell J. Nickel (1987) lidhur me “arsyet dhe motivet e urta” në mbështetje të të drejtave humane. Duke përcaktuar si pikënisje deklarimin se të gjitha qëniet humane posedojnë disa interesa themelore bazë, ai argumenton se çdo individ ka detyrën themelore dhe kryesore të respektojë të drejtat e çdo individi tjetër. Bazë për këtë detyrë nuk janë vetëm bamirësia ose altruizmi, por interesat vetjake të çdo individi. E thënë ndryshe, të drejtat e njeriut nuk respektohen vetëm duke mbajtur qëndrime bamirësie, duke u shqetësuar për interesat e të tjerëve, por duke i parë realizimin e interesave vetjakë përmes respektimit të ndërsjelltë të interesave të njeri tjetrit. Nickel shkruan se “një argumentim i urtë” i interesave themelore tenton të tregojë se të drejtat humane duhen pranuar e përmbushur, në kushtet kur edhe qëniet e tjera humane ka të ngjarë të bëjnë një gjë të tillë, sepse këto norma janë pjesë e



mënyrave më të mira të mbrojtjes interesat individuale themelore kundrejt veprimeve dhe shmangieve që i vënë në rrezik këto interesa”.

Mbrojtja e interesave themelore kërkon gadishmërinë dhe dashjen e të tjerëve për të njohur dhe respektuar këto interesa, pra në fund të fundit kërkon një njohje dhe respekt të ndërsjelltë ndaj interesave të njeri-tjetrit. Për këtë arsye, konkludojnë këta studiuesë, mbrojtja dhe respektimi i interesave themelore, kërkon ndërtimin e një sistemi kooperimi, qëllimi final i të cilit nuk është nxitja dhe përkrahja e të mirës së përbashkët, sikurse nënkuptojnë veprimet e bazuara tek altruizmi e bamirësia, por mbrojtjen e ndërsjelltë dhe nxitjen e interesave të individëve, psh duke krijuar kushtet e favorëshme që çdo individ të ketë mundësi të tregojë kapacitetet e tij dhe të realizojë interesat e veta themelore.

Për mjaft studiuesë të filozofisë të të drejtave të njeriut, ky këndvështrim përbën sot një mjet të fuqishëm argumentimi të Doktrinës të së Drejtës Humane. Ajo ka avantazhe të dukëshme për të tërhequr vëmendjen e njerzve të thjehtë në atotribute që ekzistojnë tek të gjithë, dhe në këtë mënyrë ofron relativisht një mbrojtje me bazë të gjerë të atij numuri të madhe të drejtash që konsiderohen prej shumicës si themelore dhe të pajetërsueshme. Ky këndvështrim ofron gjithashtu edhe një mundësi për të zgjidhur disa nga mosmarrëveshjet e mundëshme, që mund të lindin gjatë proceseve të përcaktimit të përparësive të disa të drejtave në raport me të tjerat. Nëse do të duhet të bëhet një prioritizim i të drejtave themelore (për nevojën e përcaktimit të prioriteteve në respektimin e të drejtave themelore, në kushtet e mungesave në burime materiale e financiare për të krijuar një nivel minimal jetese të mirë për të gjithë, folëm më sipër tek “Kategoritë e pavarura të të Drejtave të Njeriut”), këtë do ta arrimin më lehtë duke bërë një klasifikim të tyre sipas rendit të intereesave korresponduesë, duke identifikuar objektivat ose përmbajtjen e çdo të drejte.

Megjithatë, ndaj këtij përafrimi teorik ka kritika domethënëse. Ndër më të shquarat është kritika mbi thirrjen për realizimin e nevojave dhe interesave më të domosdoshme duke iu referuar disa prej raporteve të natyrës së njeriut dhe duke lënë mënjanë disa të tjera. Ky këndvështrim operon qartë, më së paku, me raportet dhe leverditë e nënkuptuara të natyrës së individit. Tërheqja drejt natyrës humane dhe individualitetit është provuar të jetë mjaft kontradiktor dhe i reziston në mënyrë tipike kërkesës për të arritur një shkallë të caktuar konsensusi në përcaktimin e legjitimitetit të çdo doktrine morale që bazohet mbi një nga raportet ose përlllogaritjet që bën individit. Psh, kombinimi i të bërit apel për interesat themelore me aspiratën e çdo individit për të pasur garanci për kushtet minimale për një jetë normale, do të komplikohet pa tjetër nga diversiteti social dhe kulturor i çdo shoqërie konkrete, sepse siç argumenton Amartya Sen (1999) kushtet minimale për një jetë modeste e të pranueshme janë relative në pikpamje sociale dhe kulturore.

Kritika ndaj këndvështrimit të teorive të interesit bazohet në faktin se ndërsa interesat në vetvete mund të jenë në fund të fundit identikë apo të ngjashëm për një numur mjaft të madhe individësh, anë e kënd globit, mbrojtja e përshtatëshme dhe garancitë për relizimin e tyre do të duhet të kapërxente përtej cakut të disa qëllimeve specifike për arritjen e parakushteve të përgjithëshme për të kënaqur këto interesa themelore të individëve.

Kritika të tjera fokusohen tek apeli ndaj interesit vetjak, si garanci për një bazë koherente për respektimin e plotë të të drejtave për të gjithë individët. Këndvështrimi i teorive të interesit, bazohet mbi supozimin se individët kanë një pozicion vulnerabiliteti relativisht të njëjtë ndaj njeri tjetrit. Megjithatë kjo nuk është një rrethanë apo çështje e tjeshtë. Modeli, që ofron këndvështrimi nuk mund të mbrojtë në mënyrë të përshtatëshme pretendimin që një faktor i interesit vetiak duhet të respektojë interesat e individëve më pak të fuqishëm ose gjeografikisht më të largët, nëse ata



dëahirojnë të sigurohen për interesat e tyre. Në këtë rast, personat e varfër e të pambrojtur nuk janë në të njëjtat kushte me ata më të pasur ose më të fuqishëm dhe për paojë nuk mund të influencojnë mbi ta.

Tërheqja drejt një interesi vetiak të pastër nuk mund të garantojë baza të shëndosha një bashkësi universale të moralit për doktrinën e të drejtave humane, sepse ajo thjesht nuk mund të justifikojë pretendimet për universalitet të tyre. E shprehur më thjesht, këndvështrimi i teorive të interesit ka prirje t'i interpretojë interesat tona themelore si parapërcaktuesë të veprimit të moralit huam. Kjo mund të ndikojë në nënvleftësimin e rëndësisë që ka ushtrimi i lirisë si ideal moral parësor. Nëse dikush do të kërkonte të përfshinte lirinë si një bazë e interesit të individit, do të dështonte sepse liria nuk është aspak bazë për interesat tona, apo së paku ato nuk ndërtohen mbi bazën e egzistencës së saj. Kjo çështje na çon në thelbin e një këndvështrimi tjetër të rëndësishëm, në atë të teorive të “vullnetit paracaktues” për të drejtat e njeriut.

□ Këndvështrimi i teorive të “vullnetit paracaktues”

Në kontrast me këndvështrimin e teorive të interesit, teoritë e “vullnetit paracaktues” orvaten të argumentojnë vleftshmërinë dhe bazueshmërinë e të drejtave humane mbi bazën e një atributi të vetëm njerëzor: kapacitetit për liri. Teoricienët e këtij këndvështrimi argumentojnë se ajo që e dallon veprimin human është aftësia dhe kapaciteti për të qënë i lirë dhe se kjo duhet të përbëjë thelbin e çdo vlerësimi dhe shkakut të të drejtave. Në fund të fundit, për pasojë, ata i shohin të drejtat e njeriut si të prejardhura ose së paku të thjeshtëzuara në një të drejtë të vetme, ose alternativë e një takëmi shumë të kufizuar të attributeve themelore e domethënëse.

Hart (1955) psh, në mënyrë konkludive argumenton se të gjitha të drejtat mund të thjeshtëzohen në një të vetme dhe themelore, kur i referohet “të drejtës së barabartë të të gjithë individëve humanë për të qënë të lirë”. Ai insiston se të drejtat për gjëra të tilla si psh pjesmarrja politike ose trajtimi i përshtatëshëm ushqimor, mund të thjeshtëzohen në fund të fundit si derivate të të drejtës së barabartë për të qënë të lirë.

Duke u përqëndruar mbi këto argumenta të Hart, Henry Shue (1996) përpunon dhe argumenton tezën e vet se vetëm liria nuk është plotësisht e mjaftueshme për tu shndëruar në një bazë për të gjitha të drejtat e parashtruara nga Hart. Ai argumenton se shumë nga këto të drejta përfshijnë më tepër sesa vetëm lirinë individuale dhe për këtë propozon zgjerimin e kësaj baze me sigurinë përballë dhunës dhe kushtet e domosdoshme materiale për mbijetesë individuale. Në këtë mënyrë ai e zgjeron dhe e ndërton bazën e të drejtave themelore të individit mbi lirinë, sigurinë dhe jetesën.

Alan Gewirth (1978, 1982) e përpunoi më tej këtë temë duke argumentuar se arsyetimi i pretendimeve dhe deklarimeve tona për zotërimin e të drejtave themelore humane bazohet në atë, që ai e quan karakteristikë dalluese të qënies humane në përgjithësi: kapacitetin për të vepruar në mënyrë racionale dhe të qëllimtë. Mbi këtë argument ai pohon se vleftshmëria e bazueshmëria e të Drejtave të Njeriut është përfundim logjik i njohjes së vetes, si qenie e qëllimtë e pajisur me arsye, sepse zotërimi i të drejtave përbën mjetin e domosdoshëm për të vepruar në mënyrë të tillë.

Sikurse shihet, arumentat e Gewirth ngrihen mbi pohimin se të gjitha qëniet humane janë të arsyeshme e të qëllimta. Çdo veprim njerëzor kryhet për disa arsye, pavarësisht nëse janë arsye të mira apo të këqija.



Duke shtruar pyetjen se çfarë kërkohet në radhë të parë për të qënë faktor racionalisht i qëllimshëm, ai argumenton se liria dhe mirëqënia janë dy nga kushtet e domosdoshme për të vepruar në mënyrë të arsyshme e të qëllimtë. Këto do të ishin dy parakushtet esenciale për individin human, mbi të cilat ai do të demonstronte se zotëron aftësitë për të vepruar në mënyrë racionale dhe të qëllimtë. Si të tilla parakushte ato duhen të jenë të garantuara për çdo individ, por, vazhdon ai, individët nuk mund t'i përdorin këto vetëm për të kënaqur vullnetin personal, pa u shqetësuar se ato u përkasin edhe të tjerëve. Këtë shqetësim për të tjerët, Gewirth e mbështet mbi atë, që e quan “Parimi i konsistencës gjenerike”: nuk mund të paracaktoj me vullnetin tim pretendimet personale për të drejtat e miya themelore, pa pranuar njëkohësisht pretendime e deklarime të njëjta nga faktorët e tjerë të qëllimshëm e racionale dhe për të njëjtat attribute bazë. Ekziston një e drejtë absolute për jetën që zotërohet veçmas dhe barabar nga të gjithë njerzit. E drejta për jetën është absolute, sepse ajo nuk mund të nëpërkëmbet asnjëherë e në asnjë rrethanë. Për këtë arsye, jo vetëm nuk mund të justifikohet asnjë dhunim i saj, por duhet plotësohet e të garantohet pa asnjë përjashtim për të gjithë.

Këndvështrimi i teorive të vullnetit parapërcaktues orvatet ta ndërtojë idenë e vleftshmërisë të të drejtave të njeriut mbi idealin e autonomisë personale - autonominë e vullnetit: të drejtat janë manifestim i përdorimit të vullnetit personal autonom. Sipas kësaj pikpamje, bazueshmëria e të drejtave themelore të individit janë të lidhura domosdoshmërisht me vleftshmërinë e autonomisë së vullnetit personal.

Megjithë forcën e qartë logjike të këtij këndvështrimi, ai përsëri ka qënë objekt kritikash të ndryshme. Një nga format më të rëndësishme të kritikës ndaj pikpamjeve të tilla është vendosja e fokusit mbi të ashtuquajturat “raste marginale”; qëniet humane që përkohësisht apo përgjithmonë nuk janë në gjëndje të veprojnë në mënyrë racionalisht autonome. Kjo do të përfshinte individët e diagnostikuar si të sëmurë nga çmëduria, skizofrenia, depresionet klinike dhe më tej individët që mbeten në gjëndje komatoze, nga e cila mund të mos kthehen asnjëherë. Nëse kushtet themelore për të gëzuar të drejtat njerzore bazohen, siç thuhet nga teoricientë e vullnetit paracaktues, janë kapacitetet për të vepruar në mënyrë racionale e të qëllimshme, për pasojë duket se individët që nuk jnë në gjëndje, për shkaqet që përmëndëm, të plotësojnë këtë kriter nuk kanë të legjitimitet për të pretenduar të drejtat e tyre. Kjo mund të duket mjaft shqetësuese nga pikpamja morale edhe për faktin se ka një tendencë të përgjithëshme për të zgjeruar vlerësimin e të drejtave të njeriut në drejtim të respektimit të tyre edhe për të ashtuquajturat “raste marginale”, ku përfshihen veç të sëmurëve, edhe kategori të tjera vulnerable dhe shpesh të paafta për të ndërmarë veprime racionale të vullnetëshme dhe të qëllimta, si fëmijët, gratë, personat me hendikap, të moshuarit, viktimat.

Të veprosht ndryshe, duke i përjashtuar sipas kriterit të vullnetit paracaktues do të duket e gabuar nga pikpamja intuitive, nëse nuk mund ta shqyrtohet atë si të pambrojtshëm duke iu referuar arsyes praktike. Si rrjedhim, aplikimi strikt i kriterit që rekomandojnë teoritë e vullnetit paracaktues për pjestarët e një komuniteti bartës të të drejtave humane, do të duket si përjashtim i disa kategorive të qënieve njerzore që tashmë janë të njohur si bartës legjitimë të të drejtave themelore të individit.

□ Këndvështrimi sociologjik: proceset dhe interesat

Për mjaft nga studiuesit, çdo diskutim teorik mbi të drejtat e njeriut në mënyrë akademike duket e paplotë dhe e pamjaftueshme. Për më tepër, shekulli i 20^{ies} e në vazhdim janë mjaft të ndryshëm nga shekulli i 19^{ies}, kur zunë fill diskutimet mbi vleftshmërinë dhe universalitetin e të drejtave humane. Përveç kushteve mjaft të ndryhme socialpolitike dhe shqetësimit për të mos u përsëritur mizoritë e Luftës së Dytë Botërore, pati një zhvillim mjaft të spikatur në fushat e shkencave të



natyrës dhe të shoqërisë. Këto shkenca të reja përpunuan një kuptim të ri mbi njerzit, kulturën, konfliktet dhe interesat e tyre. sociologjia, antropologjia, psikologjia, psikologjia sociale e të tjera disiplina, prunë zbulesat e tyre në fushën e studimeve mbi njeriun dhe shoqërinë humane. J.Shestack (1998) shkruan se të tilla zhvillime inspuruan lindjen e asaj që u quajt shkolla sociologjike e jurispondencës. Termi “shkollë”, ndoshta nuk është mjaft i gjetur, sepse arrijtjet në këtë fushë janë më tepër një numur i pngjashëm teorish, të cilat kanë emërues të përbashkët të orvatjeve, vendosjen e ligjit në një vijë me faktet e jetës njerëzore në shoqëri. Shkolla sociologjike e jurispondencës priret t’iu largohet edhe teorive a priori, edhe tipeve analitikë të jurispondencës klasike. Ky këndvështrim për sa i përket të drejtave humane, herë e drejton vëmendjen në çështjet e zhvillimit institucional, herë herë fokusohet në probleme specifike të politikave publike që kanë lidhje me të drejtat e njeriut dhe herë herë synon të klasifikojë dimensionet e mënyrave të sjelljes së ligjit dhe të shoqërisë. Në kontekstin e të drejtave humane, ky këndvështrim është i dobishëm sepse identifikon komponentët empirikë të sitemit të të drejtave të njeriut në kuadrin e proceseve sociale¹⁰.

Kontributi parësor i shkollës sociologjike është theksi i saj në mbajtjen e një ekuilibri të përherëshëm të interesave midis ndjenjave morale mbizotëruese dhe kushteve sociale dhe ekonomike të kohës dhe vendit konkret. Ka mjaft argumenta për të besuar se i gjithë ky këndvështrim sociologjik u ngrit mbi parimin pragmatist të William James se “esenca e së mirës qëndron thjesht në plotësimin e kërkesës”. Ky këndvështrim është i lidhur edhe me zhvillimet më të reja lidhur me rritjen e kërkesave dhe presioneve për plotësimin e një numuri mungesash, që dilnin nga caqet tradicionale të lirive klasike civile dhe politike - si psh çështjet e ndihmës për të papunët, handikapët, të paprivilegjuarit, minoritetet, gratë e të tjerë segmente të shoqërisë.

Ndër më të shquarat e vështrimit sociologjik është analiza e Roscoe Pound, që thekson se gjatë shekullit të 19^{ës}, historia e ligjit u shkruajt kryesisht si një memuar i pranimit në rritje të të drejtave humane.

Në shekullin e 20^{ës}, megjithatë kjo histori u desh të shkruhej në kushtet e një pranimi vazhdimisht e më të gjerë të dëshirave, të nevojave njerzore dhe interesave sociale. Pound i klasifikonte intersat si interesa individuale, publike dhe sociale. Ai nuk u përpoq që t’u jepte ndonjë shpjegim apo preferenca në vlerë për këto interesa, por duke u udhëhequr nga parimi i “inxhinjerisë sociale” e vuri theksin në rregullimin e marrëdhënieve njerzore përmes një shoqërie politikisht të organizuar, aq sa të garantojë të gjitha interesat aq sa është e mundur me sa më pak sakrifica në dëm të totalit të interesave.

Pikpamjet e Pound dhe të pasuesve të tij zgjeruan në mënyrë të dobishme kuptimin e qëllimit të të drejtave të njeriut dhe korrelacionin e tyre me kërkesat. Dallimi që bëri ai lidhur me interesat që përfshihen në këtë korrelacion mban parasysht realitetet e proceseve sociale duke treguar se fokusi mbi të drejtat duhet vendosur në kufijtë e asj që shqetëson njerzit dhe të asaj çfarë dëshirojnë ata.

Megjithatë, një teori e vetme që merr përsipër të katalogojë kërkesat humane është e pamjaftueshme për tu fokusuar në atë sesi të drejtat lidhen me njera tjetrën dhe sesi duhen përcaktuar prioritetet e tyre.

Shkolla sociologjike nuk i përgjigjet dot pyetjes se si mund të rrjedhë në mënyrë empirike një përrundim normativ lidhur me të drejtat e njeriut, nga premisa faktike si ato të interesave. Për ta bërë këtë do të duhej një shkencë deskriptive në fushën e të drejtave të njeriut, por që përsëri nuk do të ishte e mjaftueshme për të kënaqur nevojën e identifikimit të qëllimit. Teoria sociologjike sjell një metodë të dobishme, por ka nevojë edhe për një nevojë për një metodë filozofike.



DOKTRINA E TE DREJTAVE TE NJERIUT

Megjithatë, duke na dhënë një metodë sasiore të vëzhgimit të interesave që kërkojnë të plotësohen, shkolla sociologjike sqaron e thekson perceptimet për vlerat, që përfshihen në këto procese dhe të politikave që duhen për t'i realizuar këto vlera dhe interesa.

Të tri keto këndvështrime teorike, sido që nuk janë të vetmet, kanë anë të forta por edhe pamjaftueshmëri. Kur ato aplikohen veç e veç në doktrinën e të Drejtave të Njeriut, secili prej tyre duket qartë se sjell konkluzione që kufizojnë ose e dëmtojnë forcën e vërtetë të këtyre të drejtave.

Duhet të jenë përkrahësit nga fusha e filozofisë integrale, të cilët duhet të vlerësojnë potencialet dobiprurëse që mund të vijnë përmes kombinimit të shumëllojshmërisë së temave dhe elementëve që krijohen brenda këtyre këndvështrimeve (dhe të tjerave) për të argumentuar e shpjeguar të drejtat e njeriut. Në këtë mënyrë, edhe orvatjet e mëtejshme, për argumentimin e bazave dhe përmbajtjes të të drejtave humane, do të përfitojnë nga këndvështrime që janë të bazuara në tematika më pluraliste se më përpara.



Shënime:

¹ Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut është amenduar më tej gjatë rrjedhës së viteve me mjaft protokolle, deklarata dhe vendime të Gjykatës të të Drejtave të Njeriut, që ritheksojnë e përmirësojnë kushtet paraprake për garantimin e të drejtave themelore për të gjithë qytetarët e komunitetit socialpolitik dhe ekonomik europian

² William Markiewicz , 1997

³ Nga raporti i IHF: “Human Rights in the OSCE Region...- Albania”. Report 2005 (Events of 2004)

⁴ Jerome J. Shestack, “Philosophic Foundations of Human Rights” Human Rights Quarterly, 1998

⁵ Term që Dworkin e përdor për të përshkruar cilësinë që marrin disa të drejta të njeriut, përballë disa justifikimeve që mund të bëhen për vendimet në mjediset politike në emër të qëllimit të shtetit për tërë shoqërinë. Kërshtu psh, zotërimi i të drejtave nga minoritetet kundër trajtimeve diskriminuese duhet të mbivendoset ndaj çdo të drejte tjetër dhe të gjitha vlerësimeve për dobitë që mund të vijnë për shumicën prej diskriminimit të pakicës.

⁶ “...përveç disa përmirësimeve në fushën e të Drejtave të Njeriut, mbeten ende një numur problemesh. AHC, bën të ditur për përdorim të tepëruar

të forcës nga policia dhe forma të tjera të keqsjlljes policore, korrupsion në sistemin gjyqësor, mosukses në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, shtyrje e vonesa të pajustificuara në proceset gjyqësore dhe probleme lidhur me kushtet e paraburgimit dhe në burgje.” (Nga raporti

i IHF: “Human Rights in the OSCE Region: Europe, Central Asia and North America- Albania”. Report 2005 (Events of 2004)

⁷ “Ideja e së drejtës përbën një absurditet dhe ideja e së drejtës natyrore përbën një absurditet me paterica” (J. Bentham)

⁸ Tibor R. Machan “The Perils of Positive Rights” in “The Freeman: Ideas on Liberty” - 2001

⁹ “Policia dhe Qytetarët”, Botim i QSHDNJ, (KE, QSHDNJ), 2005

¹⁰ Jerome Shestack “Philosophic Foundations of Human Rights” Human Rights Quarterly, 1998

Referenca

- Dworkin, Ronald. “Taking Rights Seriously”, 1978
- Finnis, John. “Natural Law and Natural Rights”, 1980
- Gewirth, Alan. “Reason and Morality”, 1978
- Gewirth, Alan. “Human Rights: Essays on Justification and Applications”, 1982
- Joseph Raz, “The Morality of Freedom”, 1986
- H. L. Hart, “Positivism and the Separation of Law and Morals”, 1955;



DOKTRINA E TE DREJTAVE TE NJERIUT

- H. L. Hart, “The Concept of Law”, 1994
- John Austin, “The Province of Jurisprudence Determined”, 1985.
- Jones, Peter. “Rights”, 1994
- Nickel, James. “Making Sense of Human Rights: Philosophical Reflections on the UDHR”, 1987
- Shestack Jerome “Philosophic Foundations of Human Rights” 1998
- Pound, Roscoe, “Jurisprudence” § 8, 1959
- Rhoda, E. Howard, “Human Rights and the Search for Community”, 1995
- Rorty, Richard, “Philosophy and the Mirror of Nature”, 1979.
- Waldron, Jeremy. “Theories of Rights”, 1984
- Freeman, Michael. “Human Rights: An Interdisciplinary Approach”, 2002
- Nowicki, A. Marek. “Rreth Konventës Evropiane” 2003
- “Policia dhe Qytetarët”, (KE, QSHDNJ), 2005

